



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 341, Datë 21.12.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094 prot., datë 19.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 319, datë 12.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria me e-mailin e datës 13.12.2022, protokolluar në ERE me nr. 2015/1, datë 14.12.2022, ka përcjellë pjesërisht dokumentacion që lidhet me këtë aplikim
- ERE me shkresën nr. 2015/2 prot., datë 15.12.2022, ka njoftuar shoqërinë për mos fillimin e procedurës duke evidentuar edhe dokumentacionin e munguar dhe po ashtu ka bërë me dije se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, në rast se, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mos fillimin e procedurës, shoqëria paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të Aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1.1 gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar;**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 1.2, gërmat “a”, “c”, “d”. **Plotësuar;**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 1.3, gërma “a” dhe “c”. **Plotësuar;**
  - Dokumentacioni specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, Pika 2.5. **Plotësuar;**
- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin si më poshtë:
  - Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*
    - **gërma “b”: Aplikuesi nuk ka përcjellë Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.**
  - Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
    - **gërma “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE balancat aktive që disponon në llogarinë bankare.**
- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.
- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**